



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË  
REKTORATI

**VENDIM REKTORATI**  
**“MBI ZHVILLIMIN E PROVIMEVE ONLINE DHE NË AUDITOR, SEZONI I**  
**DIMRIT, VITI AKADEMIK 2020-2021”**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSh”, Statutin e UMT, neni 31, Rregulloren e UMT, Urdhrin nr. 289, datë 04.05.2020 “Për miratimin e Udhëzuesit për “Masat ndaj Covid-19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore” të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe në shkresën nr. 749/25 prot., datë 11.02.2021 të MASR, në mbledhjen e datës 11.02.2021, Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë zhvillimin e provimeve online dhe në auditorë, sipas propozimeve të njëjësive kryesore të UMT.
2. Provimet online, si dhe provimet në auditor (në respektim të masave dhe protokolleve anti-COVID), do të zhvillohen në përputhje me rregulloren e provimeve të sezonit të dimrit, viti akademik 2020-2021.
3. Studentët të cilët për arsye subjektive apo objektive, nuk do mundën të marrin pjesë në këtë sezon (në provimet online apo në auditor), do tu jepet mundësia e zhvillimit të një sezoni të ndërmjetëm, në varësi të përmirësimit të situatës së pandemisë;
4. Studentët të cilët për shkaqet e sipërcituara nuk kanë mundur të ndjekin leksionet apo seminarët online gjatë semestrit të parë nuk do të penalizohen për pjesëmarrje në provime, për këtë sezon.
5. Kohëzgjatja e sezonit të jetë deri në 45 ditë, për të krijuar diferencën kohore ndërmjet provimeve, me qëllim parandalimin e grumbullimeve në mjediset e UMT. Grafiku i sezonit të provimit dhe datat e provimeve të përcaktohen dhe publikohen nga Dekanatet e Fakulteteve në varësi të programit dhe vitit të studimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për zbatim njëjësive kryesore të UM-së.

**REKTORI**  
**ARBEN GJATA**